

ZBATIMI I ANALIZËS SË RISKUT NË AUDITIMET E PERFORMANCËS

nga Sali AGAJ – Përgjegjës sektori¹ dhe Bexhet ZEQRIRI – Audiues i lartë,
botuar në gazetën “Tirana Observer” dhe gazetën “Ekonomia”, më 16 maj 2014.



“Ndryshimi është procesi nëpërmjet të cilit e ardhmja hyn në jetën tonë”

Alvin Tofler

Në dekadën e fundit Auditimet e Performancës si një disiplinë e veçantë e auditimit në Institucionet Supreme të Auditimit (homologe të KLSH-së) të vendeve të zhvilluara vlerësohen shumë nga grupet e interesit, veçanërisht parlamentarët. Duke iu përgjigjur këtyre zhvillimeve auditimeve të performancës iu është dhënë një rëndësi parësore edhe në Kontrollin e Lartë të Shtetit. Faktorë të brendshëm dhe të jashtëm të tillë si rritja e ndërgjegjësimit për transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, forcimi i bashkëpunimit në fushën ndërkombëtare, pëlqimi nga publiku, etj. Gjithashtu profesionalizmi në fushën e auditimit ka kontribuar në zhvillimin e këtij koncepti, i cili lindi kryesisht për shkak të rritjes së nevojës në kërkimin e efikasitetit, ekonomisë dhe efektivitetit në përdorimin e burimeve publike.

Koncepti i auditimit të performancës ka filluar që në vitet gjashtëdhjetë që me shqyrtimin e efikasitetit të sistemeve operacionale, por që u materializua në v. 1986 në Sidnei të Australisë, kur Kongresi i Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INCOSAI), miratoi rezolutën për "Një auditim të ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit me të cilin subjektet e audituara përdorin burimet në ushtrimin e funksioneve të tyre."

Po kështu, standardet e auditimit të INTOSAI-t të v. 1992 përkufizojnë se Auditimi i Performancës ka të bëjë me auditimin e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit.

¹Kontrolli i Lartë i Shtetit

Një tjetër moment historik në auditimin e performancës është përcaktuar në INCOSAI në Montevideo të v. 1998, ku u ra dakord që në zbatim të Standardeve të Auditimit të INTOSAI-t (Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit) të hartohet një udhëzues mbi auditimin e performancës.

Pas një pune intensive nga ana e grupit të punës, Udhëzuesit Zbatues për Auditimin e Performancës u përfunduan dhe u dërguan për zbatim në Korrik të v. 2004, të cilat u miratuan nga INCOSAI XX në Afrikë e Jugut, si *Standarded dhe Udhëzuesit për Auditimin e Performancës bazuar në Standardet e Auditimit të INTOSAI-t dhe përvojë praktike (ISSAI 3000)*, mbi të cilat aktualisht bazohet ushtrimi i këtyre auditimeve nga KLSH.

Edhe menaxhimi i riskut njihet ndërkombëtarisht si praktikë e mirë jo vetëm në administratën publike por në të gjithë sektorët e ekonomisë, si çelësi i suksesit të organizatës në përmbushjen e detyrimeve të saj. Identifikimi dhe menaxhimi i riskut konsiderohet gjithashtu si një komponent i rëndësishëm ndryshimi në zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm i cili është pjesë esenciale e sektorit publik të vendeve anëtare dhe kandidate të BE. Pavarësisht cili është qëllimi i Institucionit, organizatës, agjensisë, entit, njësisë publike përmbushja e objektivave karakterizohet nga pasiguria ose risku, i cili është si kërcënues ndaj suksesit ashtu dhe shans për arritjen e tij.

Rrjedhojat që patën falimentimet dramatike të korporatave të mëdha Enron dhe Parmalat, në Shtetet e Bashkuara dhe Europë, nxorrën në pah rëndësinë dhe rolin e metodave të auditimit në ushtrimin e përgjegjësive të audituesve gjatë ushtrimit të auditimeve. Megjithëse falimentimet janë një realitet i biznesit, për shkak se vetë biznesi ndërmerr përsipër risqe dhe do të ketë gjithmonë kompani që dështojnë, pasi ato nuk janë në gjendje t'iu përgjigjen këtyre risqeve dhe një bote në ndryshim, në rastin e falimentimit të korporatave të mëdha që shkaktojnë kolaps në tregjet fiannciare është e pashmangshme pyetja “Ku ishin audituesit?”.

Përsiatje në metodën e auditimit me bazë risku

Në auditimin e performancës metodologjia dhe qasjet bazuar në analizën e riskut janë pothuaj të njëjta dhe njësoj të rëndësishme si në auditimin financiar. Ashtu si edhe në auditimin financiar, audituesi nuk mund të auditojë aktivitetin apo programin ekonomik njëqind për qind. Sigurisht kjo nuk është as ekonomike dhe as praktike, prandaj auditimi bazuar në vlerësimin e riskut zbatohet edhe në auditimet e performancës.

Risku i auditimit është gjasa ose rreziku që audituesi të arrijë në një përfundim dhe rekomandim të pasaktë gjatë punës audituese.

Gjatë kryerjes së auditimeve të performancës, risqet analizohen në dy nivele, në nivelin strategjik dhe në nivelin operacional.

Analiza e riskut në nivelin strategjik në KLSH kryhet për të identifikuar ose për të zgjedhur temat që do të auditohen, ndërsa analiza në nivel operacional kryhet për të identifikuar në mënyrë të hollësishme temën e zgjedhur për t'u audituar.

Qëllimi i zbatimit të metodës me bazë risku në auditimet e performancës është:

- Vlerësimi dhe minimizimi i riskut të auditimit duke e përqëndruar auditimin në zonat me risk të lartë;
- Përdorimi optimal i burimeve në dispozicion;
- Një vlerësim paraprak rreth çështjes
- Zbulimi i dobësive më të theksuara në funksionimin e programit/projektit;
- Vlerësimi dhe dokumentimi i riskut të audituesve, duke marrë parasysh si gjasat në riskun e menaxhimit dhe ato të riskut të objektivave të vetë audituesve;
- Rritja e besueshmërisë së auditimit;
- Ndhimesa për arritjen e 3E-ve (ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit) nga njësia/projekti/programi i audituar;
- Nxitja e auditimeve efektive dhe ekonomike;

Në fushën e auditimit ka shumë udhëzues që këshillojnë kritere të shumta për zgjedhjen e temave bazuar në analizën e riskut të nivelit strategjik, të cilat në vija të trasha mund të jenë ndikimi i auditimit, materialiteti, rëndësia dhe mundësia e auditimit (auditueshmëria), etj.

Vlerësimi i riskut

Pas zgjedhjes së temës së auditimit, duhet të analizohet risku që në procesin e planifikimit. Ky proces quhet vlerësimi i riskut. Ndërsa vlerëson riskun, grupi i auditimit ka nevojë të kuptojë veprimtarinë e subjektit që auditohet, duke mbledhur informacion të përditësuar paraprak dhe duke identifikuar proceset që funksionojnë për të përmbushur objektivat e organizatës/projektit/programit. Çdo proces bazë përmban në vetvete edhe risk.

Evidenca e auditimit është rezultat i një auditimi të mirëplanifikuar, prandaj një metodë auditimi me bazë rrisht në auditimet e performancës është një komponent i rëndësishëm në kryerjen e auditimit.

Teknikat apo qasjet e grupit të auditimit në kryerjen e vlerësimit të rrisht janë takimet e punës me stafin e subjektit të auditimit dhe intervistat. Për shembull, gjatë kryerjes së auditimit të performancës të një projekti infrastrukturor, procesi më i rëndësishëm operacional është "administrimi i kontratës", që përbëhet nga disa faza si, përzgjedhja e kontraktorit, zbatim, mbikëqyrja dhe monitorimi, kontrolli e cilësisë, kolaudimi, pagesa dhe dorëzimi.

Ashtu si në auditimin financiar, rrisht është i natyrave të ndryshme, audituesit e performancës fokusohen në rrishtun e brendshëm dhe në rrishtun e kontrollit.

Rrisht i brendshëm është vlerësimi nga grupi i auditimit i nivelit të arritjes së ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit nga organizata/projekti/programi/subjekti i auditimit. Metoda e auditimit bazuar në vlerësimin e rrisht të brendshëm mes tjerash, ndihmon audituesit për të marrë vendime të argumentuara profesionalisht gjatë hartimit të programit të auditimit të performancës.

Rrisht i kontrollit është rrisht që mjedisi i kontrollit i projektit/subjektit që auditohet nuk arrin të zbulojë dhe korrigjojë në kohë mangësitë në arritjen e 3E-ve, p.sh. në një investim, mjedisi i kontrollit mund të rezultojë i paefektshëm për shkak të cilësisë së dobët të ndërtimit, mungesës së monitorimit të proceseve të punës, etj. Në një rast të tillë, rrisht i përfundimit të punës ndërtimore në cilësinë e dëshiruar dhe në kohë vlerësohet i lartë. Mjedisi dhe procedurat e kontrollit janë sistemet e ngritura në organizatë/projekt/program/subjektin e auditimit për të zbutur rrishtun e kontrollit.

Pas vlerësimit të rrishtun përcaktohen pyetjet dhe nënpyetjet të cilat përbëjnë bazën e programeve të auditimit të performancës në KLSH dhe zenë kohë të konsiderueshme në punën audituese, ku gjen vend më së miri edhe një thënie e **Albert Ainshtainit** "Nëse do të kisha një orë për të zgjidhur një problem nga i cili do të varej jeta ime, në 55 minutat e para do të përcaktoja pyetjen e duhur dhe sapo të gjeja pyetjen e duhur, do të mund ta zgjidhja problemin në më pak se pesë minuta."

¹ *Shkrime të tjera të botuara nga Sali AGAJ për periudhën Janar–Qershor 2014:*

- *Borxhi publik dhe politika monetare e BSH.*

(Botuar në gazetën "Ekonomia", 17 qershor 2014.)